



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 12446 Prot
24

Divjakë më: 29/12 / 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 92 datë 29/12 / 2025

“MBI MIRATIMIN E NJË SHTESE FONDI, ARDHUR NGA MFE, NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR.11 DATË 19.12.2025 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR 115/2024 PËR BUXHETIN E VITIT 2025”

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 139/2015, date 07/12/2015 “Perveteqeverisjenvendore” neni 54 pika ç dhe dh, te ligjit nr.68/2017 dt.27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” neni 40 dhe 41 si dhe ligjin 9936 dt. 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise” neni 6.32 i ndryshuar, Udhezimit nr.9 dt.20.03.2018 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Aktit Normativ Nr.11 datë 19.12.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025, Të Udhezimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2 datë 24.01.2025 “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2025”, është akorduar **fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Divjakë në Vlerën 10,553,085 lekë. Sa më lartë I propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjakë që në mbledhjen e datës. 29/12/2025.**

Të Miratojë

1. NJË SHTESE FONDI, ARDHUR NGA MFE, NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR.11 DATË 19.12.2024 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR 115/2024 PËR BUXHETIN E VITIT 2025”, PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA.

- Shtesa e fondit në Buxhetin e Bashkisë Divjakë do të jete në vlerën 10,553,085 lekë, në bazë të shkresës nr.18059/15 datë 24.12.2025 të dërguar nga Ministria e Financave, ardhur me email paraprakisht.
- Fondet do të përdoren për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Divjakë pasi Agjensia e Shërbimeve Komunale nuk ka detyrime të prapambetura.
- Përdorimi I këtij fondi do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve të evidentuara sipas pasqyrës bashkalidhur.

2. Ngarkohet për ndjekje te procedures se ketij projekt-vendimi, Drejtorja Për Buxhetin dhe Financën.

Përgjegjës Për Sektorin Juridik
Andi BULLARI

Përgjegjëse e Buxhetit dhe MFK
Irena GJONI

Drejtor Për Buxhetin dhe Financën
Xheladin BRAHKOLA

KRYETARI
Josif GORREA